



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

## CFARE DUHET TË DINI

*Informim për sipërmarrësit mbi detyrimet e OSSHEE në sajë të menaxhimit të nderprerjeve të planifikuara të energjisë elektrike*

Pas raportimeve të vijuara të sipërmarrjes prodhuese mbi **problematikën e ndërprejes së energjisë elektrike pa njoftim paraprak**, duke shkaktuar kështu shqetësim sa i takon dëmtimit të makinerive të prodhimit, pasuar nga kërkesës e menjëhershme e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për informacion të saktë, ju bëjmë me dije se:

- Shoqëria OSHEE **komunikon informacionet dhe të dhenat për shërbimet e kryera mujore**, subjekte të niveleve të cilësisë së shërbimit tregtar të shërbimit tek ERE dhe tek instucionet e linjës dhe ato ndërkombëtare dhe gjithashtu **publikon te gjitha informacionet e saj në faqen ëeb zyrtare**.

- Shoqëria OSHEE **duhet të informojë të gjithë përdoruesit që mund të ndikohen nga ndërperjet e veçanta në SSH për datat dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve**.

- **Nëse ka kundërshtime nga përdoruesit ato duhet të merren në konsideratë** nga OSHEE dhe nëse është e mundur duhet të propozohen rregullime alternative.

- Për ndërprerjet e planifikuara shoqëria **OSHEE ka për detyrë të njoftojë ndërprerje të energjisë elektrike për mirëmbajtjet dhe riparimet e programuara**. Për këtë OSHEE përdor për njoftimin dhe informimin publik

1. median e shkruar dhe elektronike
2. faqen zyrtare ëeb
3. rrjete sociale
4. si dhe njoftimin e administratorëve të bizneseve të zonave të prekura nga ana e K/ngji të Agjensive në të gjithë Shqipërinë.

- Shoqëria OSSSHEE **duhet të deklarojë madhësinë e zonës së prekur të pakten 24 orë përpara** duke treguar gjithashtu edhe kohëzgjatjen e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Në rast mungese të zbatueshmërisë së pikave të mësipërme dhe informacioni paraprak mbi ndërprerjen e energjisë elektrike pranë biznesit tuaj, jeni të ftuar të na shkruani rastin tuaj specifik në [info@sipermarrja.gov.al](mailto:info@sipermarrja.gov.al) dhe ne do të ndjekim raportimin tuaj me prioritet.

Ministër Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,  
Sonila Qato